

KËRKESË
Nr. 4879/3, datë 10.10.2014
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Përdorura në qytetin e Korçës”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Ujësjetllës Kanalizime Korçë(UKKO) sh.a. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe për llogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

SEKTORI SHPRONËSIMEVE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË

titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë ministrisë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit “arë”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Ujësjetllës Kanalizime Korçë(UKKO) sh.a., (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 25 805 329 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e pesë mijë e treqind e njëzet e nëntë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
 INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA KORÇË

Nr.	PRONARI			Zona kadastr.	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe arë (m²)	Çmimi për njësi (lekë/m²)	Vlera (në lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
1	Sotiraq	Vani	Bicolli	8561	24/46	9000	416.6	3,749,400	Konfirmim ZRPP
2	Bujar	Meleq	Feçanji	8561	24/45	3000	416.6	1,249,800	Pa certif. pronësie, certif. e pron. nuk është lëshuar pasi nuk ka ardhur konfirmim nga KVVTP
3	Hasan	Sali	Ramollari	8561	24/44	3000	416.6	1,249,800	Konfirmim ZRPP
4	Irfete	Zeqir	Unaza	8561	24/43	4000	416.6	1,666,400	Konfirmim ZRPP
5	Marjana	Postol	Gjinko	8561	24/42	1000	416.6	416,600	Konfirmim ZRPP
6	Roland	Dhori	Mizaku	8561	24/41	4500	416.6	1,874,700	Konfirmim ZRPP
7	Stavri	Spiro	Dede	8561	24/40	5460	416.6	2,274,636	Konfirmim ZRPP
8	Enver	Muharem	Take	8561	24/39	6000	416.6	2,499,600	Konfirmim ZRPP
9	Sybi	Muharem	Take	8561	24/38	5764.0	416.6	2,401,282	Konfirmim ZRPP
10	Venetike	Sybi	Qeraxhi	8561	24/37	5.7	416.6	2,375	Konfirmim ZRPP
11	Pellumb	Hamit	Nako	8561	24/36	624	416.6	259,958	Konfirmim ZRPP
12	Ramadan	Muharem	Lipo	8561	24/35	1750	416.6	729,050	Konfirmim ZRPP
13	Fredi	Muhamet	Stringa	8561	24/34	3055	416.6	1,272,713	Konfirmim ZRPP
14	Sofia	Niko	Hoxhalli	8561	24/33	2066	416.6	860,696	Konfirmim ZRPP
15	Valter	Refat	Myrteza	8561	24/32	11406	416.6	4,751,740	Konfirmim ZRPP
16	Sabrie	Nexhip	Dishnica	8561	24/31	1312.0	416.6	546,579	Konfirmim ZRPP
Vlerat totale e shpronësimit								25,805,329	

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.1331 (13-2014-5483), datë 22.9.2014, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Bardhul Musaj, lindur më 4.10.1940, në Kishtë, Gramsh, i regjistruar aktualisht në zyrën e gjendjes civile nr.6, Tiranë, duke përcaktuar si ditë të vdekjes së tij datën 13.4.2001.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 1336, datë 19.9.2014, ka vendosur shpalljen të vdekur të shtetasit Roland Gjyli, i biri i Albertit dhe Myneveres, i datëlindjes 8.9.1978, duke përcaktuar si datë të vdekjes, datën 30.4.1998.